



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë (VU), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 774,368€;
- B2 Blerje të pasurisë jo kapitale në vlerë 651,807€ nuk ishin regjistruar në SIMFK dhe sistemin e e-pasurisë, duke shkaktuar nënvlerësim të pasurisë në raportin vjetor financiar për këtë shumë;
- B3 Detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin vjetor financiar ishin mbivlerësuar për 129,431€;
- B4 Obligimet e papaguara të shpalosura në raportin vjetor financiar ishin mbivlerësuar për 113,756€;
- A1 Nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme në raportin vjetor financiar në vlerë 34,376€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Vushtrrisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B5 Në shtatë raste të obligimeve në vlerë 81,978€, kishte vonesa në pagesës nga 5 deri 95 ditë pas afatit të lejuar për pagesë;
- A2 Në dy pagesa në vlerë 68,756€, ishin bërë ndryshime në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal;
- B6 Në një rast të procedurës së prokurimit, ishin aplikuar kritere favorizuese në specifikat e dosjes së tenderit;
- C1 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme;
- B7 Mos pagesa e qirave mujore nga shfrytëzuesit e pronave publike;
- B8 Në dy raste, kishte mangësi në monitorimin e raportimeve nga përfituesi i subvencionit;
- B9 Në pesë raste kishte dobësi në procesin e dhënies së subvencioneve për përfituesit individual.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vushtrrisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vushtrrisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vushtrrisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vushtrrisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vushtrrisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar janë: prezantimi jo i drejtë i shpenzimeve, pasuritë, obligimet e papaguara, detyrimet kontigjente, si dhe llogaritë e arkëtueshme për shkak të regjistrave të pasaktë. Sa i përket mos pajtueshmërisë me ligje, kishte dobësi tek ridestinimi i projekteve kapitale, procesi i dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, procesi i prokurimit, mos verifikimi i 20% të pronave të tatueshme si dhe vonesa në pagesën e faturave.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 16 rekomandime, prej tyre 4 janë rekomandime të reja, 11 rekomandime të përsëritura dhe 1 rekomandim i përsëritur pjesërisht.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja

Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parasë publike" neni 18, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në 16^s pagesa në vlerë prej 774,368€ kemi identifikuar se komuna përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa në kategori jo adekuate si në vijim:

- Përmes vendimeve gjyqësore përmbartimore ishin ekzekutuar shpenzime në vlerë 658,353€ për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive për paga jubilarë dhe shujta. Nga kjo vlerë, 547,313€ ishin ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale, 50,131€ nga mallrat dhe shërbimet si dhe 60,909€ nga kategoria e subvencioneve;
- Po ashtu përmes vendimeve gjyqësore, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishin paguar 75,000€ për ndërtimin e shtratit të lumit, shpenzime që për nga natyra i takojnë investimeve kapitale, si dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar 41,015€ € për asfaltime të rrugëve, shpenzime që për nga natyra i takojnë po ashtu investimeve kapitale.

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe vonesave në pagesën me kohë të obligimeve.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo

adekuate, ndikon në mbivlerësim/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke shkaktuar prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjet adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlerësim i regjistrit të pasurive kapitale dhe jo kapitale

Gjetja Rregullorja MF Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6, paragrafi 3, përcakton që: "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria".

Pasuritë e blera gjatë vitit 2024 dhe investimet në vijim nuk ishin regjistruar në regjistrat përkatës të pasurisë jo financiare, duke e nënvlerësuar vlerën e pasurisë në raportin vjetor financiar për 651,807€⁶. Në vijim, janë prezantuar detajet:

- Investime në vijim të paguara gjatë vitit 2024 për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe fushave sportive, në vlerë 607,516€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale të SIMFK-së si pasuri në vijim; si dhe
- Pasuri jokapitale të teknologjisë informative dhe pajisje të tjera, të blera gjatë vitit 2024 në vlerë 44,291€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme me rastin e regjistrimit të pasurisë dhe mos komunikimit të mirëfilltë mes drejtorive për bartjen e informative në lidhje me blerjet e vitit. Vlen të përmendet se komuna na ka ofruar dëshmi për regjistrimin e këtyre pasurive në regjistrin e pasurisë në vitin 2025, por këto ndryshime nuk ishin reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2024.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive të investimeve në vijim dhe pasurive jokapitale ndikon që vlera e pasurive të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e nënvlerësuar.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive dhe komunikim mes drejtorive ashtu që pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente

Gjetja Rregullorja e MF Nr.01/20217, për raportim vjetor financiar, Neni 6, parasheh se: “Organizatrat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”, ndërsa neni 18 përcakton që organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin financiar vjetor ishin mbivlerësuar për 129,431€, për shkak se komuna kishte prezantuar në regjistrin e detyrimeve kontigjente katër⁷ pretendimet për kompensime të pagave, për të cilat kishin përfunduar procedurat gjyqësore dhe ishin marrë vendimet përfundimtare nga gjykata. Këto shpenzime do të duhej të përfshiheshin si obligime në regjistrin e obligimeve të papaguara.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos komunikimit të mirëfilltë ndërmjet zyrës ligjore dhe asaj të financave si dhe funksionimi jo efikas i kontrolleve të brendshme në përditësimin e regjistrave kontabël.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontigjente në vlera jo të sakta ndikon në mbivlerësimin e tyre, si dhe palët e interesit apo shfrytëzuesit e raportin vjetor financiar të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve kontigjente.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë përfundimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B4 - Mbivlerësim i obligimeve të papaguara në raportin vjetor financiar**

Gjetja Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, Neni 6 parasheh se: “Organizatrat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Obligimet e papaguara nuk janë prezantuar saktë në raportin vjetor financiar, pasi që tri (3)⁸ fatura në vlerë 113,756€ të cilat ishin paguar nga komuna me datë 12 dhe 18 dhjetor 2024, ishin shpalosur si obligime të papaguara.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në menaxhimin dhe përditësimin e regjistrit të obligimeve të papaguara nga zyrtarët përgjegjës financiar.

Ndikimi Mbivlerësimi i obligimeve të papaguara ndikon në pasaktësi në raportin vjetor financiar dhe që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën tyre.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në azhurnimin e regjistrit të obligimeve të papaguara në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë

dhe i plotë i tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF

Gjetja Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, nenit 6, parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”. Dhe sipas Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10 paragrafi 1 përcakton se: “Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: pika 1.1. Institucioneve publike të Republikës së Kosovës”.

Në tetë (8)⁹ raste, komuna ka bërë prezantim jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF, me ç’rast regjistri i llogarive të arkëtueshme në raportin vjetor financiar ishte nënvlerësuar për 34,376€. Detajet e këtyre gabimeve janë si në vijim:

- Në katër (4) raste tek taksa për lejet ndërtimore kishte nënvlerësim për 60,364€, pasi që komuna nuk ka shpalosur këstet e papaguara për lejet ndërtimore;
- Po ashtu, në katër (4) raste tjera tek dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, ishin mbivlerësuar llogaritë arkëtueshme për 9,165€, si rezultat i mos azhurnimit të regjistrit;
- Në dy (2) raste me vlerë 16,823€ tek tatimi në pronë për parcela kishte mbivlerësim, komuna kishte ngarkuar me tatim në pronë tokat në pronësi publike, duke mbivlerësuar regjistrin e llogarive të arkëtueshme për këtë shumë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi Nēnvlerēsimi dhe mbivlerēsimi i llogarive të arkētueshme ndikon në prezantim jo të saktë të informatave në raportin vjetor financiar të komunës dhe që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën tyre.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B5 - Vonesë në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve

Gjetja Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), nenit 39.1 parasheh që: "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në shtatë (7)¹⁰ raste, në vlerë prej 81,978€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor. Vonesat ishin nga 5 ditë deri në 95 ditë pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo kishte ndodhur kryesisht si rezultat i mungesës së mjeteve financiare për shkak të pagesave të pa planifikuara përmes vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Tejkalmi i afatit ligjor për pagesën e faturave mund ta bëjë komunën subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbarimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal

Gjetja Ligji Nr. 08-L-260 për ndarjet buxhetore për vitin 2024, neni 16, pika 11, përcakton që: "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal"

Në dy (2)¹¹ pagesa të projekteve kapitale në vlerë prej 68,756€, ishin marrë fondet nga projekte tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Këto ndryshime në shumat e ndara buxhetore ishin bërë me vendim të Kryetarit të Komunës pa marrë aprovimet e Kuvendit Komunal për ridestininim të fondeve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos përgjegjësisë së menaxhmentit të komunës për të zbatuar kërkesat e ligjit të buxhetit lidhur me ndryshimet buxhetore.

Ndikimi Ndryshimet në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal mund të reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimet e marra rreth shfrytëzimit të fondeve publike. Po ashtu, mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese duke pamundësuar financimin e

mjaftueshëm të tyre.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Dobësi në procedurat e prokurimit publik

Gjetja Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042, neni 28, pika 2, përcakton që: autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Në procedurën e prokurimit "Blerje furnizim dhe montimi i kalldas me qiler në QMF-1" në vlerë 62,062€, komuna me rastin e përcaktimit të specifikave në dosjen e tenderit, tek pjesa B, pozicioni 1, ishin përdorur marka tregtare apo emra të prodhuesit MECO për ventilatorët-konvektorëve, pa përdorur edhe termin të ngjashëm, duke përdorur kriterë favorizuese të cilat kishin eliminuar konkurrencën.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta me rastin e përpilimit të specifikimeve teknike nga ana e njësisë kërkuese dhe zyrës së prokurimit.

Ndikimi Vendosja e kriterëve favorizuese në specifikime teknike shkakton trajtim jo të barabartë apo diskriminimin e operatorëve ekonomik dhe dëmton konkurrencën.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj kontrolle efektive tek njësitë kërkuese dhe zyrën e prokurimit me qëllim që gjatë hartimit të specifikave teknike të mos përdoren kriterë favorizuese për të siguruar që procedurat e prokurimit zhvillohen në pajtim me ligjin.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos inspektimi i 20% të pronave të tatueshme për tatimin në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 15, parasheh se: "Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës".

Komuna gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur të bëjë inspektimin apo verifikimin e së paku 20% të pronave të regjistruara brenda territorit të Komunës, mirëpo brenda vitit kishte bërë inspektimin e vetëm 9.5% të pronave të përgjithshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe angazhimeve të pamjaftueshme për verifikimin e pronave sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi Mos inspektimi i pronave rezulton me informata jo të plota të pronave aktuale dhe me ndikim në vlerësim jo të drejtë dhe të saktë të ngarkesave për tatimin në pronë, respektivisht pranime më të ulëta të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mos pagesa e rregullt e qirasë nga shfrytëzimi i pronave publike

Gjetja Kontrata e qirasë, pika 7.1 specifikon se, nëse qiramarrësi dështon të paguajë obligimet e papaguara, apo dështon në zbatimin kushteve të kontratës, atëherë qiradhënësi e njofton qiramarrësin për mos përmbushjen, dhe nëse qiramarrësi nuk e përmirëson dështimin brenda 15 ditëve, atëherë kontrata qirasë automatikisht do të konsiderohet se ka përfunduar.

Gjatë auditimit të llogarive të arkëtueshme për shfrytëzimin e pronave publike të Komunës, kemi identifikuar mangësi në menaxhimin e kontratave me qiramarrësit si në vijim:

- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00127-0, për aktivitete afariste 90m², e nënshkruar në 02.02.2017 me afat të shfrytëzimit për shtatë (7) vite dhe me qira mujore 1,000€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës, qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 30,000€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00209-0, për aktivitete bujqësore 23.45ha e cila gjendet në fshatin Gracë, e nënshkruar në 02.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira vjetore 7,070€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 5,411€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00492-0, për aktivitete bujqësore 11.97ha e cila gjendet në fshatin Balincë, e nënshkruar në 01.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira vjetore 898€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 4,118€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202022-00492-0, për aktivitete bujqësore 8.85ha e cila gjendet në zonën kadastrale në Dobërllukë, e nënshkruar në 31.10.2016 me afat të shfrytëzimit për 10 vite dhe me qira vjetore 974€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 2,016€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokën për afarizëm e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00653-0, për aktivitete afariste 13m² e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 01.08.2017 me afat të shfrytëzimit për 5 vite dhe me qira mujore 132€. Si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës

- qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,860€;
- Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afarist i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-2254/49, për aktivitete afariste 16m2 e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 03.02.2016 me afat të shfrytëzimit për 5 vite dhe me qira mujore 32€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,504€;
 - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të tokës bujqësore e cila gjendet në parcelën kadastrale nr. P-412-1, për aktivitete afariste 3.24ha e cila gjendet në fshatin Lum Madh, e nënshkruar në 15.03.2016 me afat të shfrytëzimit për 3 vite dhe me qira vjetore 583€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,458€;
 - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-1108/19, për aktivitete afariste 8.61m2 e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 04.12.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira mujore 34€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,284€;
 - Në kontratën për qiradhënie afatshkurtër të lokalit afaristë i cili gjendet në parcelën kadastrale nr. P-70202016-00001-1, për aktivitete afariste 25.2m2 e cila gjendet në Vushtrri, e nënshkruar në 04.12.2017 me afat të shfrytëzimit për 15 vite dhe me qira mujore 73€, si pasojë e mos pagesës së qirasë sipas kushteve të kontratës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 369€.

Shkaku i mos përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në kontratë ishte mos përmbushja e detyrave me përgjegjësi dhe mungesa e vendosjes së një mekanizmi efektiv për monitorimin e procesit të pronave komunale të cilat janë dhënë me qira.

Ndikimi

Mos përmbushja e obligimit financiar rrit rrezikun që të pamundësohet arkëtimi i të hyrave i cili ndikon në përmbushjen e projeksioneve buxhetore. Mos marrja e veprimeve ligjore ndaj qiramarrësve të pa përgjegjshëm mund të inkurajojë të njëjtit dhe qiramarrësit tjerë të mos përmbushin obligimet kontraktuale.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë që janë vendosur kontrole efektive për monitorimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim. Gjithashtu, për qiramarrësit të cilët nuk përmbushin kushtet e kontratës të marrë veprimet e nevojshme ligjore për mbledhjen të qirasë së pa arkëtuar nga komuna dhe të shqyrtoj mundësinë e ndërprerjes së kontratës nëse kemi të bëjmë me një shfrytëzues të pandërgjegjshëm në respektimin e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Mangësi në monitorimin e raportimeve nga përfituesi i subvencionit.

Gjetja

Marrëveshja e mirëkuptimit për financim të përbashkët në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe KBI Vushtrri, neni 2 pika 2.2 përcakton që, KBI obligohet që t'i dërgoj komunës së Vushtrrisë raport mujor në fillim të çdo muaji lidhur me progresin e marrëveshjes. Po ashtu, me marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide, neni 2 pika 2.1 ndër tjera specifikon se e njëjta do të dëshmoj faturat të shpenzimeve dhe raportit të shërbimeve të ofruara.

Gjatë testimit të monitorimit të subvencioneve kemi identifikuar këto mangësi:

- Në një mostër të subvencionimit për financim të përbashkët ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe KBI Vushtrri, me vlerë 10,000€ përfituesi nuk kishte ofruar raportet mujore të ecurisë së projektit ashtu siç parashihej me dispozitat e marrëveshjes në mes të Komunës dhe përfituesit.
- Po ashtu në një mostër tjetër nga marrëveshja për financim të përbashkët në vlerë 75,368€ në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide, përfituesi nuk kishte ofruar raportet me fatura ashtu siç parashihej me dispozita të marrëveshjes. Pas përfundimit të auditimit, komuna na ka ofruar raportet me faturat përkatëse.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së monitorimit dhe neglizhencës nga zyrtarët përgjegjës për të mbikëqyrur implementimin dhe raportimin nga përfituesit e subvencioneve.

Ndikimi Mungesa e monitorimit dhe raportimi i mangët nga përfituesit ndikon në shpenzimin jo efektiv të mjeteve dhe mosarritjes së qëllimit të dedikuar të subvencionimit.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë që të bëhet monitorimi dhe të sigurohen raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Përfituesit që nuk kanë raportuar për mjetet e shfrytëzuara të përjashtohen nga e drejta e përfitimit të subvencioneve në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B9 - Dobësi në procesin e dhënies së subvencioneve për përfituesit individual

Gjetja Rregullorja KKV nr.03/2023, për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare për persona fizik dhe juridik, neni 5, parasheh ndër të tjera ndihmë momentale për shërim për personat fizikë. Po ashtu, rregullorja e njëjtë, neni 6, pika 3, përcakton kriteret që duhet t'i plotësojë personi fizik përfitues, ndër të tjera: rekomandimin nga komisioni i ekspertëve i drejtorisë përkatëse bashkë me raportet mjekësore dhe diagnozën e personit dhe dëshminë mbi gjendjen e rëndë sociale të personit fizik, të verifikuar nga komisioni i drejtorisë përkatëse.

Gjatë testimit të procedurave¹⁴ të subvencionimit kemi identifikuar këto mangësi:

- Në katër (4) raste në vlerë 18,000€, të subvencionimit për shërim të personave fizik me sëmundje të ndryshme, me vendim të Kuvendit Komunal, përfituesit nuk i kishin plotësuar kriteret e parapara me rregullore, pasi që dosjeve u mungonte rekomandimi nga komisioni i eksperteve të drejtorisë përkatëse dhe dëshmia e gjendjes së rëndë sociale. Për më tepër, në dy raste në vlerë 10,000€, subvencionimi ishte bërë për trajtim jashtë vendit, jo në përputhje me rregulloren e brendshme e cila parasheh vetëm ndihmë momentale për shërim. Trajtimi i pacienteve jashtë vendit është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë përmes Fondit për Sigurime Shëndetësore, bazuar në

Ligjin nr. 04/L -249 për sigurimin shëndetësor, përkatësisht Udhëzimin administrativ (MSH) nr. 03/2023 për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

- Në një rast të subvencionimit në vlerë 3,000€ për ndihmë momentale për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, përfituesit i mungonte dëshmia e gjendjes së rëndë sociale.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos zbatimit të procedurave dhe akteve rregullative përkatëse nga ana e personave përgjegjës gjatë vlerësimit të kërkesave për subvencionim.

Ndikimi

Dhënia e subvencioneve në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe në kundërshtim me rregulloren në fuqi ndikon në trajtim jo të barabartë, rritë rrezikun që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe qëllimi i subvencionimit mos të arrihet.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi dhe miratimi i kërkesave për subvencionim të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore dhe brenda fushëveprimit ligjor të komunës. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrja në procesin e vlerësimit të kërkesave për të parandaluar miratimin e ndihmave në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ose për qëllime që tejkalojnë kompetencat e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 8,175,845€, prej tyre në vitin 2024 ishin shpenzuar 6,569,464€. Struktura e investimeve kapitale përbëhet nga investimet në infrastrukturën rrugore, rregullimin e lumenjve, mirëmbajtjen investive, ujësjellës, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Çështja A3 - Mospërdorim i modulit në E-prokurim për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës së kontraktuesve

Gjetja Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që: “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Më tutje, sipas nenit 70.24: “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Në dy (2)¹⁵ kontrata në vlerë 2,844,197€, menaxherët e kontratave nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë dhe transparent të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B10 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Rregullorja 001-2022 për prokurimin publik, neni 70.23, "Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave". Kontrata, neni 1.3 përkatësisht 1.5 përcakton që: përfundimi i të gjitha punëve do të duhej të kryheshin brenda viti 2024.

Ne kemi vërejtur se në kontratat e listuara më poshtë, kishte vonesa në

realizimin përtej afatit të përcaktuar të përfundimit të punimeve:

- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Bekim Berisha Abeja dhe rrugës Vëllezërit Feka” në vlerë 778,251€, e lidhur më 25.08.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024 kontrata ishte realizuar vetëm 67%;
- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Lumni Surdulli” në vlerë 685,260€, e lidhur më 25.08.2023 e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 79%;
- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Avni Saraçi dhe rrugën Viciana” në vlerë 250,019€, e lidhur më 25.08.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 75%;
- Kontrata “Ndërtimi i kanalizimit Lot 3” në vlerë 579,485€ e lidhur më 17.07.2023, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite kalendarike, do të duhej të përfundonte më 30.10.2024, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 88%.

Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur si rezultat i planifikimit jo të mirë dhe mos përbushjes së kushteve për realizim të projekteve para lidhjes së kontratave, si dhe për shkak të mungesës së mjeteve për përfundimin e tyre sipas dinamikës së paraparë.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mosarritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 122,223,116€, pasurive jokapitale 235,823€, si dhe e stoqeve 34,994€.

Çështja A4 - Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja Rregullorja nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 11 përcakton që: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi”.

Në tetë (8) mostra në vlerë 657,981€, pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2020, për të cilat nuk është bërë ende pranimi teknik, figurojnë në regjistër si investime në vijim, edhe pse të njëjtat shfrytëzohen nga komuna dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej zhvlerësimi. Në pamundësi të sigurimit të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, ne nuk kemi mundur të kalkulojmë vlerën e gabimit të zhvlerësimit, përkatësisht vlerën e mbivlerësimit të pasurisë në PFV.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

Ndikimi Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduara që janë në përdorim nga komuna ndikon në paqartësinë e statusit të tyre duke shkaktuar vlerësim jo të drejtë dhe raportim të pa saktë të tyre.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2024 në total janë 7,495,076€. Vlera e të arkëtueshmëve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë, taksat për menaxhimin e mbeturinave, leje ndërtimore, taksat për biznese, qiraja nga shfrytëzimi i pronave komunale, etj.

Çështja B11 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Ligji Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 27 përcakton që: “Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori”. Po ashtu, Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, neni 7, pika 3, përcakton se “Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e taksës së mbeturinave, për çdo muaj të vitit ose me këste. Më tutje, Vendimet përkatëse të nxjerra nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, përcaktojnë afatet e pagesave të kësteve për leje ndërtimore.

Llogaritë e arkëtueshme, në krahasim me vitin 2023, kanë shënuar rritje për 15.45%, apo 998,282€. Rritja kishte ndodhur te tatimi në pronë 33% dhe taksa për grumbullimin e mbeturinave 17%.

Në 19 raste të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 275,451€, në nëntë (9) raste të lejeve ndërtimore në vlerë 349,473€ dhe në 13 raste të taksës për grumbullimin e mbeturinave në vlerë 3,902€ komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore përmes përmbaruesit për mbledhjen e këtij borxhi, edhe pse ishte tejkalluar afati i përcaktuar në kontratë dhe afati në shkresat për rikujtimin e borxhit.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mos inkasimi i të arkëtueshmeve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B11

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁶	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	26,770,039	29,388,678	27,485,167	26,213,118	18,327,419
Grante Qeveritare - Buxheti	23,351,885	24,380,001	23,348,947	21,238,617	15,281,820
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	158,056
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,560,105	1,367,218	2,561,003	1,426,001
Të hyrat vetanake	3,418,154	3,418,154	2,754,605	2,411,650	1,392,598
Donacionet vendore	0	6,200	2,000	1,848	48,236
Donacionet e jashtme	0	24,217	12,396	0	20,707

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,618,639€. Kjo rritje është rezultat i mjeteve shtesë nga granti qeveritar prej 1,028,117€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 1,560,105€ dhe donacioneve 30,417€.

Në vitin 2024 Komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar 94% të buxhetit përfundimtar, me një rënie në realizim të buxhetit prej prej 1% krahasuar me vitin 2023, ku realizimi ishte 95%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	26,770,039	29,388,678	27,485,167	26,213,118	18,327,419
Pagat dhe mëditjet	13,209,301	14,270,147	14,268,929	12,140,868	10,100,514
Mallrat dhe shërbimet	4,840,000	5,122,737	4,932,574	4,416,993	3,306,294
Komunalitë	571,000	580,268	486,810	447,458	381,075
Subvencionet dhe transferet	1,223,000	1,238,680	1,227,390	1,129,213	1,183,529
Investimet Kapitale	6,926,738	8,176,845	6,569,464	8,078,586	3,356,007

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,060,846€. Kjo rritje vjen kryesisht për mbulimin e obligimeve që kanë rrjedh nga kontrata kolektive.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 282,737€, në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat bartjes së të hyrave vetanake dhe donacioneve për mbulimin e nevojave të komunës për shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa, ekzekutimi i buxhetit në këtë kategori ishte 96%.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte rritur për 9,268€ me buxhetin fillestar. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit kishte arritur mbi 84%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 15,680€, në krahasim me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen për subvencionimi e fermerëve, subvencionimin e kulturës, arsimit dhe sportit nga të hyrat e bartura nga viti paraprak dhe donacioneve. Realizimi në këtë kategori ishte rreth 99% e buxhetit final.
- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte rritur për 1,250,107€. Kjo rritje ishte për financimin e projekteve kapitale që do përmirësojnë infrastrukturën e komunës. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 80%, për shkak se disa projekte kishin mbetur pa realizuar për arsye të vonesave që kanë ndodhur gjatë realizimit të kontratave, si rezultat i problemeve pronësore apo uzurpimi i pronës publike.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2024 ishin në vlerë prej 2,975,945€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga licencat, të hyrat nga participimet, të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i hapësirës publike. Për vitin 2024, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 3,418,154€, me një ngecje në realizim për 442,209€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave, ka ulje prej 432,078€, që kryesisht i përket të hyrave të tatimit në pronë.

Në shumën totale të pranimeve për vitin 2024, nuk janë të përfshira edhe të hyrat nga gjobat në trafik, gjobat nga Gjykatat dhe Agjencioni i Pyjeve në vlerë prej 595,536€, të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), e të cilat i alokohen Komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	3,418,154	3,418,154	2,975,945	3,408,023	2,569,400
Të hyrat tatimore	1,333,527	1,333,527	665,169	1,268,599	969,623
Të hyrat jo tatimore	2,084,627	2,084,627	2,310,775	2,138,724	1,599,777
Të hyrat tjera	0	0		700	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2023 të Komunës së Vushtrrisë ka rezultuar me 27 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, 15 rekomandime janë zbatuar, 11 rekomandime nuk janë zbatuar dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë dhe i plotë në PVF.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e qirasë për shfrytëzimin e pronave publike përmbushen nga qiramarrësit sipas kushteve kontraktuale, dhe në rast dështimi, kontratat e qirasë të ndërpriten. Për borxhet e papaguara të ndërmerren veprime ligjore për inkasimin e tyre.	Komuna nuk ka ndërmarr veprimet te nevojshme për adresimin e rekomandimit.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike për projektet kapitale nuk tejkalojnë shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore, dhe shumat e planifikuara në planin vjetor të prokurimit	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që te kontrata me peshim të mos aplikohet rritja prej 30% te vlerës së kontratës bazë. Gjatë realizimit të kontratës, të ruhet e njëjta përqindje apo raport i peshimit të kategorive/pozicioneve siç janë kontraktuar.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se kalkulimi i zbritjeve nga baza tatimore e pronave me vendbanim parësor aplikohet saktë, dhe se veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha pronave/objekteve brenda territorit të Komunës.	Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme, ndërsa sa i përket bazës së tatimpaguesve komuna kishte ndërmarr veprime të nevojshme.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për të siguruar plotësimin dhe përditësimin e të dhënave për tatimpaguesit në sistemin ProTax.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
7.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se procedurat e rekrutimit të punonjësve zhvillohen sipas kërkesave ligjore dhe kritereve të përcaktuara me konkursin publik. Të përmirësohen kontrollet e brendshme në organizimin e testit me shkrim, dhe se në kontratat me afat të caktuar të përcaktohet saktë afati kohor i angazhimit.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të pagohen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të vonesave në pagesë të faturave.	Nuk ka filluar zbatimin

9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që në Marrëveshje të përcaktohen saktë specifikimet teknike që kanë të bëjnë me lokacionet, hapësirat punuese, orarin ku do të kryhen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit, si dhe numrin e punonjësve që do të angazhohen në ofrimin e atyre shërbimeve.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se procesimi i pagesave bëhet vetëm pasi të jetë konstatuar se faturat përmbajnë çmimet e sakta ashtu siç janë kontraktuar.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
11.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, për raportimin e tyre që të arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas memorandumit, dhe monitorimeve apo raportimeve sipas kërkesës së rregullore përkatëse.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të duhura për forcimin e kontrollit të brendshme në mënyrë që kërkesat për dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme për subvencione.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planit vjetor për subvencionim dhe i njëjti të dërgohet te zyra e qeverisjes së mirë në ZKM, si dhe përgatitjen dhe publikimin e raportit vjetor për përfituesit e subvencioneve sipas kërkesës rregullative.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
14.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që procesi i vlerësimit për subvencione të jetë në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrje publike për subvencione.	Komuna ka ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e rekomandimit.	I zbatuar
15.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se kontraktimi i punëve për projektet kapitale të bëhet duke zbatuar llojin adekuat të procedurës së prokurimit publik. Rekomandimet e KRPP-së të merren në konsiderohet dhe të zbatohen nga zyra e prokurimit. Të shtohen kontrollet në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Edhe këtë vit janë identifikuar mangësi, duke mos zbatuar procedurën adekuate të prokurimit apo duke përdorur emra tregtar.	Nuk ka filluar zbatimin

16.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që fondet publike për blerje të përdoren në mënyrën më ekonomike duke mundësuar që të merret vlera për para. Automjetet e dedikuara për njësinë e zjarrëfikjes të jenë në përputhje me kërkesat e UA (MPB) nr. 08/0219.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
17.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar hartimi i projekteve ekzekutive.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
18.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike të realizohen sipas afateve kohore dhe kushteve tjera kontraktuale. MK për çdo raport të punëve të sqarojnë arsyet e vonesave, dhe në rastet kur ato janë të paarsyetuara, të aplikohen penalet. Gjithashtu, drejtoria e financave përmes sistemi PIP, në baza tremujore, të raportoj për progresin fizik dhe financiar në departamentin e buxhetit.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe këtë vit kemi hasur që projektet kapitale nuk janë realizuar sipas afat të kontraktuar.	Nuk ka filluar zbatimin
19.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që në rastet kur kontratat publike nuk arrijnë të përfundohen brenda periudhës së kontraktuar, siguria e ekzekutimit të kontratës vazhdohet edhe për një periudhë shtesë në të cilën parashihet finalizimi i kontratës. Pagesat përmbyllëse të kontratave të mos realizohen pa u siguruar paraprakisht garancioni bankar i kualitetit të punimeve.	Komuna kishte marrë masa për ta zbatuar këtë rekomandim, nga mostrat e testuara ne nuk kemi hasur në ndonjë rast ku sigurimi ekzekutimi të ketë skaduar.	I zbatuar
20.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë së menaxherët e kontratave zbatojnë në tërësi kushtet e veçanta të kontratës, dhe nga secila pagesë e situacioneve të aplikojnë mbajtjen e parasë në 10% të vlerës në rastet kur nuk ofrohet garanci bankare nga kontraktuesit.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
21.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara,	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
22.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse në përputhje me planin kontabël.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste ku shpenzimet janë keq klasifikuar.	Nuk ka filluar zbatimin

23.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari i pasurisë të regjistrojë të gjitha pasuritë kapitale në SIMFK, dhe pasuritë jokatipale në e-pasuri. Pasuritë e regjistruara si investime në vijim, e të cilat kanë përfunduar si projekte, të rialokohen në kodet përkatëse të pasurisë që i takojnë.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që edhe këtë vit kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
24.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, pasi që LLA vazhdojnë të rriten dhe komuna nuk zbaton masat e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
25.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës ruajnë dhe sigurojnë dhe mirëmbajnë dokumentacionin burimor për të hyrat nga taksa në biznes. Ndaj borxhlinjve të ndërmerren veprime ligjore për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara.	Në këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast sikurse përshkruhet në rekomandimin e vitit paraprak.	I zbatuar
26.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e papaguara prezantohen drejtë dhe saktë në PVF.	Edhe këtë vit janë hasur gabime në prezantim të obligimeve në PVF.	Nuk ka filluar zbatimin
27.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin në tërësi të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe që NjAB-në ta plotësojë me numrin e mjaftueshëm të auditorëve.	Komuna ka ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e rekomandimit.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Donjeta Rama, Anëtare e ekipit



Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2024
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ferit Idrizi 

Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Data: 03.06.2025, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Vendime gjyqësore specifikac 2, 109,383€, Vendim gjyqsor specifikacion 106,779€, Specifiacion 74,407€, Specifikacion 35,600€, VGJ specifikacion 33,102€, BD TRADE SHPK 75,000€, VGJ Specifikacion 90,909€, Vendime Gjyqësore 21,364€, Vendime Gjyqësore/Specifikacion 20,843€, Vendime Gjyqësore specifikacion 32,978€, NPSH Bageri 25,000€, Vendim Gjyqësore/specifikacion 20,000€, Vendime Gjyqësore 17,138€, Specifikacion 18,315.01€, NNT ABC SH.P.K 15,000€, Specifikacion 20,372€ .
- ⁶ Blerjet të projektorëve për shkollën e mesme teknike (më pak se 1000€) 3,641€, Fusha sportive 38,919€, Ndërtimi i rrugës "Bekim Berisha ABEJA 152,235€, Ndërtimi i rrugës "Bekim Berisha ABEJA 224,361€, Paisje tjera te teknologjise informative dhe te komunikimit 3,600€, Ndërtimi i trotuareve fsh. Deberllug, Stanoc, Akrashtice 40,000€, Paisje per kompjuter 23,426€, Paisje tjera 8,932€, Paisje tjera të teknologjisë informative dhe te komunikimit 4,692€, Riasfaltimi i rrugës R220 para fillimit të urës deri te Llamkosi 38,000€, Ndërtimi i rrugës "Lumni Surdulli" 113,999€
- ⁷ C.nr. 292-2022 në vlerë 44,826 euro, CPP NR. 82/2024 në vlerë 27,316.61euro, CPP nr. 79/2024 në vlerë 30,197.48euro, dhe CPP nr.76/2024 në vlerë 27,191euro
- ⁸ Rehabilitimi i rrugës nga magjstralja deri në Dumnicë të Epërme 50,000 € ishte paguar më 12.12.2024, Rrugë lokale 45,000€ ishte paguar më 12.12.2024, Rehabilitimi i rrugës Dëshmorët e Kombit 20,000 ishte paguar më 18.12.2024.
- ⁹ Premium Building SH.P.K me vlerë 19,075€, Dijari Estate SH.A me vlerë 26,121€ dhe Ariani Company SH.P.K me vlerë 15,187€; Kontratat për Qiratë nga shfrytëzimi i pronave publike - Bujqësi; Muharrem Syla me vlerë 7,907€, Mehdi Neziri me vlerë 1,171€ dhe Nazmi Januzi me vlerë 162€ . Tatimi nëpronë - Parcela; Republika e Kosovës me vlerë 6,213€ dhe Komuna e Vushtrrisë me vlerë 10,610€
- ¹⁰ "Shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse" në vlerë 3,065.00 Euro , "Material për zyre " në vlerë 5,521.00 Euro , "Furnizime mjekësore " në vlerë 6,978.68 Euro, " Furnizim me veshmbathje" në vlerë 8,000.00 Euro , " Furnizime mjekësore-Reagenca" në vlerë 15,000.00 Euro, "Furnizime për zyre " në vlerë 4,564.00 Euro
- ¹¹ Asfaltimi i rrugës Gracë, 16,722€, Asfaltimi i rrugës Kollë, 18,756€
- ¹² Mentor Hajrizi 369 euro, Naim Jetullahu 1,284 euro, Bajram Ibrahim B.I 1,504 euro, Fatmir Ferizi 30,000 euro, NSH"Lotaria e Kosoves" Ramadan Veseli 1,860 euro, Muharrem Syla 5,411 euro, Mehdi Neziri 1,458 euro, Nazmi Januzi 2,016 euro, BLEAK ROSE SH.P.K 4,118 euro.
- ¹³ KBI Vushtrri 10, 000 euro. Projekti i themelimit të portalit të Këshillit të Bashkësisë Islame Vushtrri. ISLAMIC RELIEF NDERTIMI I SERRAVE 75,68 euro.
- ¹⁴ Engjell Grabanica 5,000 euro, Remzi Rashica 5,000 euro, Drilon Haradinaj 5,000 euro dhe Nasuf Aliu 3,000 euro, Hamit Sejdiu 2,000 euro.
- ¹⁵ Ndërtimi i projektit Udha e Gurit 359,717€ dhe Mirembajta e objekteve të AK 2,486,480€
- ¹⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.